

KËRKESË
Nr. 195/4, datë 21.5.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësimin e pasurive të paluaj-tshme të pronarëve, sipas tabelës bashkëlidhur.

Subjekti kërkuar është Bashkia e Tiranës.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vlera e shpronësimit të pronarëve, për shkak të rikonstruksionit të rrugës “Robert Shvarc”, të Bashkisë së Tiranës është 944 706 (nëntëqind e dyzet e katër mijë e shtatëqind e gjashtë) lekë.

Ky publikim do të jetë për një periudhë 1-javore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në Minis-trinë e Punëve të Brendshme.

ZËVENDËSMINISTËR I PUNËVE
TË BRENDSHME
Elona Gjebrea

**Lista e personave dhe pronave që do të shpronësohen për efekt të rikonstruksionit të rrugës
“Robert Shvarc”, Bashkia Tiranë**

Nr.	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Truall/ m ²	Çmimi/ m ²	Vlefë /lekë	Konfirmim ZVRPP
1	Mustafa Gjata	8260	6/324	30	22493	674,790	Nr. prot. 18812/1, datë 13.12.12
2	Shpresa Dervishi me 2 bashkpronarë	8260	6/271	12	22493	269,916	Nr. prot. 18812/1, datë 13.12.12
Totali				42		944 706	